



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.4/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Kujtim Pasuli kryesues, Hidajete Gashi Alaj dhe Ramush Bardiqi anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së subjektit politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, të paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr. protokollit 01/3562/2025, të datës 02.12.2025, për shkak të mos çertifikimit për pjesëmarrje në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, që do të mbahet më 28 Dhjetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, me datë 05.12.2025, merr këtë:

V E N D I M

APROVOHET ankesa e subjektit politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, e paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr. protokollit 01/3562/2025, datë 02.12.2025, NDRYSHOHET vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr. protokollit 01/3562/2025, datë 02.12.2025, ashtu që PRANOHET rekomandimi i Zyrës për Çertifikim dhe Kontroll Financiar në KQZ, i datës 02.12.2025, ÇERTIFIKOHET subjekti politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, për pjesëmarrje në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të cilat do të mbahen më 28 dhjetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 03.12.2025 PZAP ka pranuar ankesën e parashtruar nga subjekti politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, me të cilën e ka kundërshtuar vendimin e KQZ-së të datës 02.12.2025, me nr. 01/3562/2025, duke theksuar se përfaqësuesi i autorizuar i këtij subjekti, në përputhje me afatin e dhënë përmes platformës zyrtare në internet, paraqiti kërkesën për konfirmimin e subjektit të tyre politik për pjesëmarrje në zgjedhjet e parakohshme parlamentare në Kosovë, të cilat janë caktuar për 28 dhjetor 2025, Zyrës për Regjistrim, Konfirmim dhe Kontroll Financiar të Subjekteve Politike (ZRKKFSP).

Më 02.12.2025, Zyra për Regjistrim, Konfirmim dhe Kontroll Financiar të Subjekteve Politike (ZRKKFSP) pranë Komisionit Qendror Zgjedhor dha rekomandimin ku konstaton se subjekti politik Lista Serbe paraqiti dokumentacionin në përputhje me ligjin për zgjedhjet e përgjithshme dhe rregullat përkatëse të Komisionit Qendror Zgjedhor dhe se si parti e regjistruar, parlamentare, plotësoi të gjitha kriteret ligjore për konfirmimin e pjesëmarrjes në zgjedhjet e parakohshme parlamentare që do të mbahen më 28 dhjetor 2025.

Sipas parashtruesit të ankesës, përkundër një rekomandimi kaq të qartë të Komisionit kompetent, Komisioni Qendror Zgjedhor nuk konfirmoi subjektin politik Lista Serbe, edhe pse në shpjegimin e këtij vendimi të paligjshëm nr. 01/3562-2025 thuhet qartë: "Partia politike Lista Serbe përfundoi aplikimin e saj për konfirmim për pjesëmarrje në zgjedhjet e parakohshme që do të mbahen më 28 dhjetor 2025, përmes platformës elektronike të KQZ-së, Zyra ka kryer të gjitha kontrollet e nevojshme të dokumentacionit për aplikimin e partisë dhe ka konfirmuar se ajo plotëson të gjitha kriteret për aplikim dhe se pas përfundimit të të gjitha hapave të nevojshëm për kontrollin dhe verifikimin e aplikimit të partisë politike Lista Serbe për konfirmimin e kësaj partie, Zyra për Regjistrim, Konfirmim dhe Kontroll Financiar të Subjekteve Politike (Zyra) rekomandoi KQZ-së për konfirmim si subjekt politik për pjesëmarrje në zgjedhjet e parakohshme.

Sipas parashtruesit të ankesës vendim i Komisionit Qendror Zgjedhor është në kundërshtim me nenet e mëposhtme të Ligjit nr. 08/L-228 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, përkatësisht nenin 16 konfirmimi i subjekteve politike, neni 17 sshqyrtimi i aplikimeve për konfirmim, Neni 26 dispozita të përgjithshme. Dispozitat nga nenet e përmendura të Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme përcaktojnë kushtet ligjore që subjekti politik dhe kandidatët duhet të plotësojnë gjatë kandidimit, andaj Komisioni Qendror Zgjedhor nuk ka të drejtë të refuzojë në mënyrë arbitrare, pra të mos konfirmojë ndonjë subjekt politik ose kandidat. Sipas parashtruesit të ankesës Komisioni Qendror Zgjedhor ka shkelur nenin 45 të Kushtetutës së Kosovës, i cili parashikon në vijim: Neni 45 E drejta për të zgjedhur dhe për të marrë pjesë *"1. Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka mbushur tetëmbëdhjetë vjet, madje edhe në ditën e zgjedhjeve, ka e drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet, përveç nëse kjo e drejtë kufizohet me vendim të gjykatës."* Me normat kushtetuese të cituara më sipër, rregullohet e drejta aktive dhe pasive e votimit dhe me të parashikohet se kushdo që ka mbushur 18 vjeç ka të drejtë të marrë pjesë në zgjedhje si zgjedhës, të zgjedhë, që është komponenti aktiv i kësaj të drejte, ose të zgjidhet, që do të thotë të kandidojë në zgjedhje që është komponenti pasiv i kësaj të drejte.

Më tej është thënë se me nenin 73 të Kushtetutës dhe nenin 30 të Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme përcaktohen kushtet dhe kufizimet që personat nuk kanë të drejtë të kandidohen dhe nën cilat kushte nuk kanë përshtatshmëri të jenë kandidatë në zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale. Këto kufizime janë strikte dhe janë kategoritë e përcaktuara saktësisht të personave që nuk mund të përdorin të drejtën pasive të votimit (të zgjidhen) dhe komponentin e saj pasiv. Nënkuptohej që të tjerët kanë të drejtë duke qenë se Ligji dhe Kushtetuta nuk i kufizojnë në ushtrimin e kësaj të drejte. Rekomandimi i Komisionit me të cilin propozohet konfirmimi i Listës Serbe është më se i qartë dhe i miratuar në mënyrë ligjore duke respektuar Ligjin për zgjedhjet e përgjithshme. Kjo do të thotë se konfirmimi i subjektit politik nuk është çështje vullneti të mirë i ndonjë anëtari të Komisionit Qendror Zgjedhor, por detyrim ligjor i çdo anëtari të Komisionit Qendror Zgjedhor të konfirmojë çdo subjekt politik që ka plotësuar kushtet e parashikuara me ligj. Dhe veprimi i anëtarit të Komisionit Qendror Zgjedhor duhet të jetë i çliruar nga ndikimi politik, por i bazuar në respektimin e parimeve të kushtetutshmërisë, ligjshmërisë, imparcialitetit dhe profesionalizmit.

Nga arsyet e paraqitura është propozuar që PZAP të marrë vendimin me të cilin do të vërë jashtë fuqisë vendimin e paligjshëm dhe jo kushtetues të Komisionit Qendror Zgjedhor në përputhje me praktikën gjyqësore të mëparshme të PZAP-it, vendimin Anr.03/2025 nga 23.8.2025 dhe vendimin Anr.12/2024 nga 25.12.2024. PZAP të pranojë ankesën si të bazuar, të konstatojë se vendimi i Komisionit Qendror Zgjedhor për të mos konfirmuar subjektin politik Lista Serbe është i paligjshëm dhe jo kushtetues dhe se i njëjti është në kundërshtim me nenet 31. dhe 45 të Kushtetutës së Kosovës, si dhe në kundërshtim me nenet 16, 17, 26, 27 dhe 30 të Ligjit nr. 08/L-228 për zgjedhjet e përgjithshme, si dhe të urdhërojë Komisionin Qendror

Zgjedhor që të konfirmojë subjektin politik Lista Serbe në përputhje me Ligjin nr. 08/L-228 për zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë.

Në përgjigje në ankesë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka sqaruar gjithë ecurinë e procesit të zhvilluar nga ana e saj, duke theksuar se pas pranimit të Dekretit të lëshuar nga Presidentja e Republikës së Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka miratuar Planin e aktiviteteve kohore për organizimin dhe administrimin e procesit zgjedhor (Vendimi i KQZ, Nr. 01/3395-2025). Sipas këtij plani, periudha e aplikimit për certifikim të subjekteve politike është caktuar të filloj nga data 24.11.2025 dhe të përfundoj me datën 30.11.2025. Ndërsa, periudha e dorëzimit të listave të kandidatëve të subjekteve politike që certifikohen nga KQZ, është caktuar të filloj me datën 24.11.2025 dhe të përfundoj me datën 07.12.2025. Nga data 24.11.2025 deri me datën 30.12.2025, gjithsejtë njëzetekatër (24) subjekte politike kanë aplikuar për certifikim: 11 subjekte politike të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës; 7 parti politike të regjistruara; 3 koalicionë; 2 iniciativa qytetare; 1 kandidatë të pavarur. Nga njëzet e katër (24) subjekte politike që kanë aplikuar, Zyra ka rekomanduar certifikimin e njëzet e tri (23) subjekteve politike, ku KQZ në mbledhjen numër 87/ 2025, datë 02.12.2025 ka certifikuar vetëm njëzet e dy (22) subjekte politike, ku subjekti politik i regjistruar, i përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës në legjislaturën e fundit Srpska Lista, nuk ka marrë votat e mjaftueshme për certifikim (2 votë për, 2 kundër dhe 7 abstenime).

Zyra ka konsideruar se rekomandimi për certifikimin e subjektit politik Srpska Lista është në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Rregulloren Zgjedhore Nr. 04/ 2025 Certifikimi i subjekteve politike dhe i kandidatëve të tyre, ku ky subjekti politik, i regjistruar si parti politike, dhe i përfaqësuar në legjislaturën e fundit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, për tu certifikuar si subjekt politik në zgjedhjet që mbahen me datën 28.12.2025, obligohet t'i këtë të shlyera gjokat e shqiptuara të pa paguara nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) dhe Zyra për Regjistrimin, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike (Zyra), siç përcaktohet në paragrafin 13 të nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës. Meqenëse kjo parti politike nuk ka gjoka të shqiptuar nga PZAP, KQZ ose Zyra, është rekomanduar për certifikim në KQZ . Të gjitha subjektet politike që aplikojnë për certifikim, i nënshtrohen certifikimit nga KQZ: Sipas pikës 1.43 të paragrafit 1 të nenit 3 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, “subjekt i certifikuar politike do të thotë subjekti politik, që është partia politike, koalicioni i partive politike, nisma qytetare ose kandidati i pavarur, i cili është i certifikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në përputhje me këtë ligj dhe me rregullat e KQZ-së”; Sipas paragrafit 1 të nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës përcaktohet se “me qëllim të pjesëmarrjes në zgjedhje, subjekti politik duhet të certifikohet për atë qëllim nga KQZ”; Sipas paragrafit 3 të nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës përcaktohet se “Partia politike e regjistruar është automatikisht e certifikuar, por duhet të njoftojë Zyrën brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga deklarimi i datës së zgjedhjeve nga Presidenti i Kosovës për çfarëdo ndryshimi për kryetar të partisë, përfaqësues të autorizuar të partisë, ose përfaqësues financiar të partisë dhe çfarëdo informata të nevojshme lidhur më këso lloj ndryshimesh. I njëjti paragraf, ka qenë i përfshirë edhe në ligjin e shfuqizuar për zgjedhje (Ligji Nr. 03 L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës) por që Zyra në të gjitha proceset zgjedhore në të kaluarën, duke përfshirë edhe këtë proces zgjedhor, ka rekomanduar certifikimin e subjekteve politike, përfshirë edhe ato që janë të regjistruara si parti politike. Sipas paragrafit 5 të nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, KQZ certifikon subjektin politik, me të drejtë pjesëmarrjeje nëse i njëjti e dorëzon aplikimin e plotësuar, në formën e përshkruar dhe në datën e vendosur nga rregullat e KQZ-së. Në këtë rast, subjekti politik obligohet t'i përbush deri në dymbëdhjetë (12) kërkesa siç janë përcaktuar në këtë paragraf (5.1 deri 5.12) varësisht nëse subjekti politik, është parti politike e regjistruar, koalicion, apo

iniciativë qytetare, ku disa prej tyre vlejné për partitë politike të regjistruara, siç janë: nën paragrafi 5.1: Certifikata e regjistrimit, e cila lëshohet vetëm për partitë politike të regjistruara; nënpragrafi 5.3: kopja e shenjës së partitë (që nënkupton edhe partinë politike të regjistruar); nën paragrafët 5.2, 5.3 dhe 5.4 vlejné edhe për partitë politike të regjistruara; deklaratat e nënshkruara sipas nënparagrafëve 5.6 dhe 5.7 vlejné edhe për partitë politike të regjistruara.

Në mbledhjen e 87 të KQZ-se të mbajtur me datë 02.12.2025 ku është prezantuar rekomandimi i ZRCKFSP, dhe në diskutimet e bëra nga anëtarët është ngritur çështja se a do të duhej të certifikohen partitë politike që janë të regjistruara, meqenëse sipas nenit 16 paragraf 3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në mënyrë taksative theksohet se “partia politike e regjistruar është automatikisht e certifikuar”, por duhet që brenda 15 dite nga shpallja e zgjedhjeve të njoftoj Zyrën për çfarëdo ndryshimi për Kryetar të partisë, përfaqësues të autorizuar, ose përfaqësues financiar të partisë dhe çfarëdo informata të nevojshme lidhur me këso ndryshimesh. Duke pas parasysh se në këtë proces zgjedhor është hera e parë që ndahet aplikimi i subjekteve politike nga aplikimi i listës së kandidatëve të subjekteve politike, ku subjektet kishin afat deri me datë 30 nëntor të dorëzojnë aplikimin, ndërsa lista e kandidatëve deri me 07 dhjetor, një pjesë e anëtarëve, duke përfshirë Kryesuesin ishin të mendimit që nuk do të duhej të ketë rekomandim për certifikim për partitë politike të regjistruara, pasi që neni 16 par. 3 i LZP, është i qartë në këtë drejtim, por që ato parti të regjistruara në mënyrë automatike duhen të përfshihen në listë të pjesëmarrjes në zgjedhje. Të vetmet subjekte politike që do të duhej të ishin në rekomandim janë subjektet e reja dhe koalicionet. Ky qëndrim është kundërshtuar nga një pjesë tjetër e anëtarëve të KQZ, të cilët janë të mendimit se për çdo proces zgjedhor duhet të ketë certifikim të partive politike dhe duhet të ketë vendim për certifikim për pjesëmarrje në proces zgjedhor, siç është arsyetuar edhe në rekomandimin e Zyrës. Meqenëse nuk kishte kompromis në mesin e anëtarëve të KQZ-së, të gjitha subjektet politike të përfshira në rekomandimin e Zyrës, përfshirë këtu edhe partitë politike të regjistruara, koalicionet dhe subjektet e reja, janë votuar një nga një. Në këtë votime, me rastin e votimit të partisë politike Srpska Lista, certifikimi i kësaj të fundit nuk ka kaluar, pasi që ishin 2 vota për, 2 vota kundër dhe 7 abstenime, dhe rrjedhimisht certifikimi është refuzuar për këtë parti politike. Duke pas parasysh të lartcekurat, është e rëndësishme që PZAP, me rastin e vendosjes sipas ankesës në rastin konkret, të trajtoj edhe çështjen se a do të duhej partitë politike të regjistruara të certifikohen për proces zgjedhor, apo janë të certifikuara në mënyrë automatike dhe janë pjesë e listës për pjesëmarrje në zgjedhje me vet aplikim.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa – PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, gjeti se:

Ankesa është e bazuar.

Paneli vlerëson se, në bazë të shkresave të lëndës, rezulton se subjekti politik Lista Serbe, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datën 28.12.2025, ka përfunduar aplikimin për certifikim të subjekteve politike në Zyrën për Regjistrim, Çertifikimin dhe Kontrollin Financiar të subjekteve politike në KQZ. Ndërkaq, Zyra për Regjistrim, Çertifikimin dhe Kontrollin Financiar të subjekteve politike në KQZ, më datë 02.12.2025, ka nxjerrë rekomandim me të cilin është konstatuar se subjekti politik Lista Serbe i ka plotësuar kushtet ligjore për t’u certifikuar për pjesëmarrje në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datën 28.12.2025.

KQZ-ja, në mbledhjen e mbajtur më datë 02.12.2025, nuk e ka miratuar rekomandimin e Zyrës për çertifikimin e subjektit politik Lista Serbe. Në arsyetimin e vendimit të marrë në këtë mbledhje thuhet se “Pas diskutimeve, rekomandimi i prezantuar nga Zyra, për çertifikimin e partisë politike Serbska Lista, mori 2 vota për, 2 vota kundër dhe 7 abstenime. Rekomandimi

në fjalë nuk mori 2/3 e votave të nevojshme për tu certifikuar siç kërkohet me paragrafin 4 të nenit 63 të LZP-së”.

Për të vendosur lidhur me këtë çështje PZAP i është referuar bazës ligjore si në vijim: Me nenin 16 të LZP-së janë përcaktuar kushtet për certifikimin e subjekteve politike, të cilat kushte subjekte duhet t'i plotësojnë në mënyrë që të marrin pjesë në zgjedhje. Në paragrafin 5 të këtij neni parashihet se: *“KQZ-ja e certifikon subjektin politik me të drejtë pjesëmarrjeje nëse i njëjti e dorëzon aplikimin e plotësuar, në formën e përshkruar dhe në datën e vendosur nga rregullat e KQZ-së”*. Me nenin 17 par. 1 i LZP-së parasheh se: *“Zyra shqyrton të gjitha aplikimet dhe nëse përcakton se subjekti politik nuk ka plotësuar të gjitha kriteret të përcaktuara me nenin 16, të këtij ligji, atëherë Zyra është e obliguar që dhjetë (10) ditë pas pranimit të aplikimit për certifikim dërgon një njoftim me të cilin e informon subjektin politik lidhur për arsyen ose arsyet pse aplikimi i tij nuk është i mjaftueshëm”*, kurse me paragrafin 3 të këtij neni parashihet se: *“Zyra i bënë rekomandim me shkrim KQZ-së për apo kundër miratimit të secilit aplikim që pranon brenda pesë (5) ditëve nga pranimi i dokumentacionit të plotë. Rekomandimet përmbajnë shpjegim të shkruar për secilin kriter. Asnjë parti nuk certifikohet nëse nuk i plotëson kriteret e përcaktuara më tutje”* ndërsa me paragrafin 4 të këtij neni parashihet se: *“Pas pranimit të rekomandimit nga Zyra, KQZ-ja e miraton ose e refuzon aplikimin për certifikim brenda shtatë (7) ditëve”*.

Rregullorja Zgjedhore Nr.04/2024 e KQZ-së, për Certifikimin e Subjekteve Politike dhe Kandidatëve të tyre, përkatësisht neni 2 pika 2 shprehimisht parasheh se: *“Pas përmbushjes së kërkesave sipas paragrafit 1 të këtij neni, partia politike e regjistruar do të jetë automatikisht e certifikuar përveç nëse Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa (PZAP) konfirmon se një parti politike nuk i ka paguar gjokat e shqiptuara në zgjedhjet paraprake apo ndonjë detyrim tjetër, përfshirë këtu edhe gjokat e shqiptuara nga KQZ apo është sanksionuar sipas nenit 15 të Rregullores Nr. 01/2024 Regjistrimi dhe funksionimi partive politike”*.

Paneli, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe arsyetimit të KQZ-së të përmbajtur në vendimin e ankimuar të datës 02.12.2025, me numër protokolli 01/3562/2025, vlerëson se një qëndrim i tillë nuk mund të pranohet si i drejtë dhe i ligjshëm, pasi është në kundërshtim me dispozitat ligjore që rregullojnë procedurat e aplikimit dhe certifikimit të subjekteve politike.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa (PZAP) nuk pajtohet me vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për moscertifikimin e subjektit politik Lista Serbe. PZAP vlerëson se ky vendim është në kundërshtim me dispozitat ligjore të sipërcekura, pasi vetë KQZ-ja kishte përcaktuar paraprakisht planin dhe periudhën kohore brenda së cilës subjektet politike duhej të aplikonin për certifikim, ndërsa subjekti në fjalë e ka respektuar plotësisht këtë afat ligjor. Në këtë drejtim, PZAP thekson se Zyra për Regjistrim, Çertifikim dhe Kontroll Financiar në KQZ ka paraqitur një rekomandim pozitiv, duke konstatuar se Lista Serbe i ka plotësuar të gjitha kushtet ligjore të parapara me nenet 16 dhe 17 të LZP-së për t'u certifikuar për pjesëmarrje në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të cilat do të mbahen më 28.12.2025. Megjithatë, pavarësisht rekomandimit profesional dhe ligjërisht të mbështetur, KQZ vendos ta refuzojë certifikimin pa dhënë ndonjë arsye të vlefshme ligjore.

Nga shqyrtimi i vendimit të ankimuar, PZAP konstaton se KQZ nuk ka ofruar asnjë arsyetim për refuzimin e rekomandimit të Zyrës kompetente brenda institucionit, përkatësisht të Zyrës për Regjistrim, Çertifikim dhe Kontroll Financiar të subjekteve politike. Vendimi i KQZ-së është i mangët, jo i plotë dhe nuk i trajton çështjet dhe faktet vendimtare që lidhen me vlerësimin e kushteve ligjore për certifikimin e subjektit politik. Në mungesë të një arsyetimi të tillë, vendimi nuk përmban as vlerësimin e duhur të fakteve në raport me dispozitat ligjore të LZP-së dhe me Rregulloren nr. 04/2024 për Certifikimin e Subjekteve Politike.

PZAP vlerëson se, kur subjekti politik ka respektuar afatet e përcaktuara nga KQZ dhe mekanizmi i brendshëm profesional i këtij institucioni ka konstatuar përmbushjen e të gjitha kushteve ligjore për certifikim, është detyrim ligjor që vendimmarrja të bëhet mbi bazën e kriterëve dhe faktit të vlerësuar në përputhje me ligjin dhe rekomandimet profesionale të mekanizmave të brendshëm.

Andaj, PZAP vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, konform nenit 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili shprehimisht parasheh se: *“Nëse organi epror vlerëson se ankesa është e pranueshme dhe e bazuar, ai duhet të vendosë përfundimisht me një akt të ri që të anulojë apo ndryshojë, plotësisht apo pjesërisht, aktin e ankimuar, gjegjësisht do të nxjerrë aktin e kërkuar nga pala.”* Duke u bazuar në këtë dispozitë, PZAP ka vendosur të aprovoj ankesën e subjektit politik Lista Serbe dhe ka pranuar rekomandimin e Zyrës për Regjistrim, Çertifikim dhe Kontroll Financiar i datës 02.12.2025, ashtu që e certifikoj subjektin politik Lista Serbe, pasi KQZ refuzoi certifikimin pavarësisht rekomandimit pozitiv të mekanizmit të brendshëm dhe pa dhënë asnjë arsyetim lidhur me kushtet dhe kriteret ligjore për moscertifikim. Ky vendim siguron respektimin e procedurave ligjore dhe garanton certifikimin për subjektin që ka përmbushur të gjitha kushtet ligjore.

Në pajtim me nenin 115 par. 1 lidhur më nenin 118 par. 1 dhe 5 të dhe 119 LZP-së si dhe nenit 13 par.2 të Rregullores nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
ZP. A.nr.4/2025, datë 05.12.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.